

KONTRATA SOCIALE PUKË

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
LËVIZJA RINORE PËR DEMOKRACI



Suedi
Sverige



RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA PUKË

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Gusht 2019 – Gusht 2020



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



Association for Registration of Local Areas



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:
Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorës,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky Raport është Përgatitur nga Qendra “Lëvizja Rinore për Demokraci Pukë” në kuadër të projektit POP 2019 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi e vetëm autorëve.

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	3
FALENDERIME	4
HYRJE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE	6
MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK PAS KONSTITUIMIT TË TIJ.	7
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE:	10
REKOMANDIME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
ANEKSE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	Prioritetet kryesore të identifikuara gjatë vitit 2019
LRD	Qendra Rinore Puke
GADC	Aleanca Gjinore për Zhvillim

Falenderime

Për të hartuar këtë raport të monitorimit të bashkisë Pukë për periudhën gusht 2019 – gusht 2020 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë administratën e Bashkisë Pukë për bashkëpunimin dhe informacionin e ofruar.

Falenderojmë qytetarët që janë pjesë e procesit të përcaktimit të prioriteteve të kontratës sociale dhe vazhdojnë të jenë pjesë e procesit përmes monitorimit, raportimit, takimeve të ndryshme që organizata lokale ka zhvilluar përgjatë kësaj kohe, anëtarët e rrjetit POP si edhe Qendrën “Aleanca Gjimore për Zhvillim” (GADC) organizata lider në Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët po na ndihmojnë nëpërmjet një bashkëpunimi të mirë që LRD të përmbushë detyrat e përcaktuara gjatë zbatimit të këtij projekti.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin “Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)” në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura. Bashkia Pukë nuk e ka nënshkruar si dokument por është njohur me të.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me “Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal.” Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të kontratës sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, LRD Pukë, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë muajve gusht 2019 - gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve Mars – Qershor 2020 fokus të vecantë iu kushtua menaxhimit të situatës Covid 19, vendimarrjes së këshillit Bashkiak dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Pukë¹.

¹ <https://popnetëork.al/en/raporti-i-monitorimit-bashkia-puke-2/>

Përmbledhje Ekzekutive

Procesi i formulimit të prioriteteve të kontratës sociale

Kontrata sociale e bashkisë Pukë u hartua sipas një plani konkret dhe metodologjie të përcaktuar paraprakisht. Takime me komunitetin u zhvilluan dhe u moren të gjitha problematikat që prekin banorët që jetojnë në Pukë qytet dhe në katër njësitë administrative Gjegjan, Qelez, Rape e Luf – Qerret.

Publikimi i prioriteteve të kontratës sociale

Çështjet e diskutuara në forumet civile janë përfshirë në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Zhvillimi ekonomik vendor
2. Shërbimet publike
3. Dimensioni social
4. Demokracia vendore

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. Ndërhyrje prioritare, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. Ndërhyrje disi prioritare, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;

U formuluan dhe listuan sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti, 14 prioritetet të cilat janë të bashkëngjitura si aneks në këtë raport.

Keto prioritet u listuan dhe u votuan në takime me fokus grupe të ndryshme kryesisht të rinj e gra ku ju dha prioritet të gjitha kërkesave që paraqitëm në Kontraten Sociale e cila i është prezantuar administratës së bashkisë Keshillit Bashkiak dhe kryetarit të Bashkisë në takime publike me pjesëmarrje të gjërë të komunitetit, kontrata e hartuar nga qendra rinore ka shërbyer që në planet e bashkisë të futen pikërisht këto prioritetet edhe në planet e investimeve edhe në

detajimin e prioriteteve të përcaktuara nga administrata e bashkisë dhe që miratohet në këshill në fillim të vitit.

Në listën e prioriteteve që bashkia ka për vitin 2020 – 2021 kemi vërejtur se 65 % e këtyre prioriteteve parashikohen sipas kontratës sociale, kryesisht prioritete që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë të pijshëm, kanalet vaditëse, kanalizime të ujrave të përdorura, një rëndësi e veçantë po i jepet zhvillimit të turizmit si një fushë shprese për të rinjt dhe komunitetin në përgjithësi.

Monitorimi i Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pas konstituimit të tij.

Qendra Rinore ka monitoruar të gjitha mbledhjet e këshillit Bashkiak të cilat kanë filluar me datë 29 korrik ku u bë konstituimi i këshillit të ri të bashkisë. Në këshillin e bashkisë janë 15 antëar nga të cilët 3 femra e 12 burra dhe i perkasin vetëm krahut të majtë politik.

Me datë 29 korrik është zhvilluar Konstituimi i këshillit bashkiak të Pukës, ku kreu i këtij këshilli me votë unanime u zgjodh z.Enver Sulejmani, nënkryetar z.Eduart Gjoka dhe anëtar i këshillit të qarkut z.Ndue Lala. Pas procesit të votimeve për strukturat drejtuese të këshillit u bë dhe betimi i kreut të bashkisë së Pukës, z.Gjon Gjonaj. Pjesmarrës në mbledhjen e konstituimit të këshillit ishin deputeti i qarkut të Shkodres, z.Luan Harusha, prefekti, z. Çesk Millja dhe drejtuesi i ri politik i PS në qarkun e Shkodres z.Vadrin Pjetri dhe përfaqësues të institucioneve vendore. Për të pasur hapsira të mjaftushme për pjesmarrje ky takim i parë është zhvilluar në sallën e leksioneve në pallatin e kulturës.

Me datë 24 shtator Këshilli bashkiak i Pukës u mbledh në mbledhjen e tij të radhës për muajin shtator 2019. Sipas rendit të ditës, u miratuan:

- Deklaratat e dorëheqjes për tre antarë këshilli nga komisioni i vërtetimit të mandateve. U ngritën komisionet e përhershme të këshillit sipas procedurës.
- Në zbatim të ligjit nr 57/2019 u miratua edhe projekt-vendimi për dhënien e ndihmës ekonomike duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Gusht 2019.
- Miratimi i projekt-vendimit për buxhetin e vitit 2019.

- Antarët e këshillit miratuan edhe listën e këshilltarëve që do jenë të ngarkuar nga këshilli për të marrë pjesë në zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave.
- Antarët e këshillit vendosën gjithashtu miratimin e propozimit të një grupi qytetarësh për nderimin me titullin “Qytetar Nderi”, znj. Liza Gjonaj (pas vdekjes) me motivacionin: “Për kontributin e çmuar intelektual dhe personal në zhvillimin e mirëqënies social-ekonomike të komunitetit të Pukës si brenda dhe jashtë vendit”.
- Këshilli mori në shqyrtim dy kërkesa nga komuniteti për të cilat antarët e këshillit ngarkohen për ndjekjen e problemit dhe gjetjen e zgjidhjeve.

Me datë 27 dhjetor 2019 u zhvillua mbledhja e këshillit të bashkisë ndër pikat e rendit të ditës ishte dhe:

- Miratimi i projekt buxhetit 2020 dhe afat mesëm si dhe miratimi i listës së prioritetëve të bashkisë për vitin 2020.
- Në këtë mbledhje moren pjesë 14 nga 15 këshilltar, ku të gjitha pikat e rendit të ditës kaluan pa debate ndërsa tek buxheti 2020 u kërkuar specifikime për zëra të ndryshëm të parashikuar, dhe nuk u miratua pa u pasqyruar ndryshimet e propozuara nga një grup antarësh.
- Buxheti total me transfertat e kushtezuara dhe të pakushtezuara dhe grantet e deleguara për 2020 është parashikuar të jetë 427.532 mijë lekë.
- Miratimi i listës së prioritetëve për 2020 ka parashikuar rreth 65 % të prioritetëve të listuara në paktin social, kryesisht sa i takon përmiresimit të infrastrukturës të rrugëve rurale, ujësjellës e kanalizime, kanale vaditës, ura, mure mbajtëse etj.

Këshilli Bashkiak Pukë që nga periudha e shpalljes së Pandemisë COVID-19 në datë 9 Mars, pas infektimeve të para në Shqipëri, është mbledhur online në datë 26.3.2020, ku është miratuar projekt – vendimi për miratimin e fondit 6% të trajtimit të familjeve pa të ardhura ekonomike si dhe projekt- vendimin për nderimin me titull “Qytetar Nderi” të z. Ndue Marinaj (pas vdekjes)

Po ashtu me datë 28.04.2020 është zhvilluar mbledhje online e këshillit bashkiak përmes platformës Skype ku u miratua:

- Projekt – vendimi për miratimin e fondit 6% të trajtimit të familjeve pa të ardhura ekonomike,

- Emërtimi i një rruge “Signa”, në kuadër të procedurës për binjakëzimin e bashkisë Pukë me komunën Signa në Itali, rruga që do të mbajë këtë emër do të jetë nga kryqezimi i Qendra për zhvillimin e turizmit deri tek kroi pranë ish çetës vullnetare.
- U ngrit dhe grupi i punës nga antarët e këshillit për rregulloren e funksionimit të këshillit bashkiak.

Me datë 3 qershor 2020 është zhvilluar mbledhja e këshillit bashkiak, e para në kushte normale pas situatës të krijuar nga COVID-19.

- Anëtarët e pranishëm të këshillit bashkiak miratuan me votë unanime
- Projekt-vendimin për miratimin e fondit 6% të Ndhmës Ekonomike
- Projekt-vendimin për bashkfinancimin me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Parkut të Lojrave të Aventures që do të realizohet si një investim unik në qytetin e Pukës
- Miratimin e Komisionit për Rregulloren e re të Këshillit Bashkiak.

Me datë 30 qershor u zhvillua mbledhja e këshillit Bashkiak,

- Dorëhiqet nënkryetati i këshillit bashkiak z.Eduart Gjoka
- Nënkyetar i këshillit bashkiak zgjidhet z.Pjetër Gjergji.
- Miratohet ndihma ekonomike
- Miratohet rregullorja e funksionimit të këshillit bashkiak.
- Krijohet një komision tjetër për rrugën e Kavlinave, i cili ka afat 15 ditë për zgjidhjen e konfliktit ose miratimin e hapjes të rrugës sipas kërkesës së banorëve.

Me datë 30 korrik u zhvillua mbledhja e këshillit bashkiak. U miratuan:

- Ndhma Ekonomike
- Miratimi i fondit 6%
- Dhënja e ndihmës për familjen e Gazmend Laçit pas zjarrit që përfshiu banesën e tyre.
- Miratimin e projekt-vendimit për hapjen e rrugës në lagjen Laçaj.
- Miratimin e projekt-vendimit për prishjen e objektit të ish DSHP (Drejtoria e Shendetit Publik).

Me datën 04.09.2020 u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Pukë. U miratuan :

- Projekt-vendimi për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Korrik 2020.
- Projekt-vendim për një shtesë në vendimin nr.47, datë 17.12.2004, "Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë".
- 3.Të tjera,

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale:

Prioriteti nr. 2 Rregullimi dhe ndërhyrja në rrugët në nivel Bashkie Në infrastrukturën rrugore u investua dhe u përmirësuan:

Me një investim prej 31,110,619 lekë, i financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për bashkinë Pukë, është realizuar shtresa me asfalt e unazës të qytetit Pukë e cila ishte kthyer në një shqetësim të madh për përdoruesit e automjeteve veçanërisht pas ndërtimit të pedonales dhe që ky aks rrugor ishte kryesor për hyrje daljet në Pukë. Më pas është realizuar dhe vijëzimi i rrugës kryesore dhe të çdo rruge të brendshme të qytetit të Pukës, ku janë marrë në konsideratë të gjitha llojet e parkimit të mjeteve lëvizëse.

Me një vlerë prej 30,959,400 lekë pa tvsh nga Buxheti i bashkisë Pukë është realizuar invstimi në sistemimin dhe asfaltimin e rrugës së lagjes Kukaj, i listuar si prioritet komunitar prej vitesh. Është realizuar projekti i ndriçimit në rrugen e lagjes Zezaj në qytetin e Pukës.

Është përmirësuar dhe rritur kujdesi i mirmbajtjes së rrugëve rurale në njësitë administrative Luf-Qerret lagjia Sutaj në fshatin Korthpulë, Gjegjan përmirësimet e trases në aksin Kalivare-Kimëz, Qelez rruga auto e lagjes Gugaj, Rrape hapjen e rrugës auto në lagjen Palucaj në fshatin Breg realizuar me mbështetjen e një biznesmeni të zonës (Mark Luli).

Është ndërtuar ura auto në fshatin Kabash që i jep zgjidhje izolimit përgjatë stinës së dimrit të lagjes Breg dhe pjesës tjetër të këtij fshati, me një fond prej 3.396.121 lekë, financuar nga

Banka Botërore me fondet e qeverisë Suedeze në kuadër të projektit "LAG", ura e ndërtuar shmang izolimin e bashkë me të dhe rrezikun që iu kanosej banorëve në kohë me reshje.

Po ashtu në disa prej fshatrave të njësisë administrative Luf - Qerret është bërë ndërhyrje për përmirësimin e urave këmbësore të cilat kanë qenë shumë të amortizuara dhe të rrezikshme për banorët.

Një tjetër investim i rëndësishëm ka filluar zbatimin në Bashkinë e Pukës me objekt: "Optimizimi i Rrjetit të Ujësjellësit të Qytetit Pukë" Ky investim rreth 90 mln lekë do të Sistemoj me matje konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë në qytetin Pukë dhe lagjet periferike".

- Sistemimi i dy linjave të transmetimit në lagjen Zezë Pukë.
- Sistemim i linjës shpërndarese të lagjes me tubacion PE.
- Sistemim i linjave të gjithë abonenteve familjarë dhe jofamiljarë me tubacion PE, puseta, kolektore, ujëmatës për çdo konsumator familjarë dhe jofamiljarë.
- Sistemim me ujëmatës në bokse i gjithë abonentëve familjarë, ente private, enteve shtetërore në të gjitha pallatet e qytetit Pukë.
- Sistemim në matje me linja të reja shpërndarese për çdo abonent familjarë dhe jofamiljarë në puseta me kolektore dhe ujëmatës, në lagjet Mehaj, lagje e Re, Laçaj, Kukaj, Grumbullim qyteti Pukë.

Prioritet 6: Unifikimi i shërbimit dhe cilësisë së pastrimit për të gjitha zonat që janë pjesë e bashkisë Pukë. Shtimi i koshave në njësitë administrative dhe zonat perifke ku mungojnë dhe kontroll më i shpeshtë nga bashkia.

Shtimi i hapsirave të gjelbërta dhe përmirësimi i shërbimeve

- Një kënd pushimi dhe çlodhje është krijuar për qytetarët si dhe këndi i lojrave për fëmijë në parkun e Liqenit i cili është kthyer në një atraksion turistik tashmë të preferuar për të gjithë vizitorët dhe banorët e Pukës.
- Është investuar e përmirësuar një hapsirë të gjelbër pranë Qendrës së Turizmit dhe Zhvillimit Rural si dhe është krijuar një tjetër hapsirë e gjelbër dhe kënd pushimi që i mungonte kompleksit të pallateve të banimit pranë bashkisë.

- Lulishtja, ndriçimi, stolat e pushimit dhe parkimi kanë ndikuar në përmirësimin e një sipërfaqeje të konsiderushme të qytetit.
- Është bërë evakuimi i mbetjeve inerte të depozituara në mënyrë të papërgjegjshme nga qytetarë apo biznese që kanë kryer punime të ndryshme dhe inertet më tej i kanë depozituar në kuroren me pisha pranë stadiumit të qytetit të Pukës duke e kthyer një sipërfaqe të konsiderushme nga e degraduar e dëmtuar nga mbetjet në një sipërfaqe të pastër e më vonë të gjelbëruar.
- Sektori i shërbimeve të bashkisë me kontributin e Shoqatës AgroPuka ka mbjellë rreth 300 fidan lule dekorative duke ju dhënë bukuri dhe dekor zonave të ndryshme.

Për çështjet mjedisore:

Bashkia Pukë ka ndjekur me shqetësim situatën e krijuar si pasojë e ndotjes në Lumin Fan nga sterilet e Bakrit lëshuar nga Fabrika e Pasurimit të Bakrit në Fushë Arrëz. Me tu njoftuar nga banorët e zonës, të cilët me të drejt janë të shqetësuar, bashkia Puka ka ngritur grupin e punës, i cili ka verifikuar situatën në terren². Në bashkëpunim me ministrinë e mjedisit bashkia do zhvillojë një projekt për të zhdukur procesionaren një krimb që dëmton pishen deri në tharjen e saj.

KANALET KULLUESE VADITËSE

Megjithëse është bërë më herët punë në lidhje me kanalet kulluese vaditëse, dhe aty ku janë egzistente në përgjithësi cilësia dhe gjendja e tyre është e mirë. Por, banorët shprehin problematikën e mungesës së këtyre kanaleve në shumicën e fshatrave, si dhe, mungesën e pastrimit të tyre (aty ku egzistojnë) nga ana e bashkisë.

² <https://bashkiapuke.gov.al/reagim-i-bashkise-puke-lidhur-me-ndotjen-e-shkaktuar-ne-lumin-fan/>

Prioritet 9/1 komunitar: Ndërtimi dhe rikonstruksioni i kanaleve kulluese/vaditëse në të gjitha zonat ku e kanë të nevojshme si dhe mirëmbajtja e kanaleve egzistuese nga ana e bashkisë.

Në investimet e kullimit dhe vaditjes janë investuar:

Rehabilitimi i digës të Rezervuarit të Kukajve, është një investim i akorduar nga Ministria e Bujqësisë për llogari të bashkisë me vlerë 18,846,895 lekë me Tvsh investim që i garanton jetëgjatësinë kësaj veprë të rëndësishme hidrike që mbulon me nevojën e vaditjes dhjetra hektarë tokë. Po ashtu bashkia është duke përgatitur dhe një projekt për ndërtimin e shëtitores rreth këtij rezervuari duke e kthyer në atraksion turistik.

Një tjetër investim i rëndësishëm është kanali vaditës i fshatit Qerret në njësinë administrative Luf-Qerret. Rehabilitimi i kanalit vaditës në fshatin Qerret ka një vlerë prej 14,814,818 lekë pa tvsh, fond i Qeverisë Shqiptare në kuadër të projektit "Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit" Projekti bën të mundur përmirësimin e sistemit vaditës të Qerretit përmes linjave që shtrihen nga rezervuari i Kukajve, ku konsiston në rehabilitimin e kanalit ekzistues dhe kthimin e tij në parametra optimal për të zgjidhur një herë e mirë problemin e vaditjes në këtë fshat.

Ky investim i bashkangjitet investimit që po kryhet në digen e ujëmbledhësit të Kukajve dhe investimit për kanalin vaditës të Lufit realizuar dy vite më parë.

Spektori i shërbimeve ka realizuar përmirësimin e kanalit të vaditjes për 12 familje në lagjen Sulaj të fshatit Shkozë, njësia administrative Gjegjan, në lagjen Bacaj në fshatin Gojan i vogël dhe të lagjes Lajthizë po në Gjegjan

Realizime për strehimin:

Bashkia Pukë ka në dispozicion 24 apartamente, pjesë e kompleksit të banesave sociale ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave në bashkëpunim me Bashkinë Pukë, ku në vijimësi do iu jepen familjeve përfituese sipas vlerësimit të këshillit bashkiak.

Ish NSHN është një pallat pranë Shkollës së mesme "Sabah Sinani" në qytetin e Pukës ku jetojnë disa familje dhe kushtet janë jashtë çdo norme për të jetuar dhe e amortizuar deri në rrezik për banorët, bashkia po fillon rikonstruksionin e tij.

Prioritet 4: Adresimi dhe listimi prioritar për ngritjen e shërbimeve për grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Në shërbimet sociale:

Ka filluar rikonstruksioni i Qendrës Komunitare pranë bashkisë Pukë me fondet e UNDP-së, e cila do të përshtatet në shërbim të fëmijëve, grave të dhunuara, të moshuarve, personave me aftësi ndryshe.

Në mbledhjen e këshillit bashkiak të zhvilluar në Korrik vetë kryetari i bashkisë ka propozuar që të mund të raelizojnë punë komunitare me persona nga skemat e ndihmës ekonomike të ardhura të cilat janë në nivele shumë të ulta, për të ju dhënë mundësinë e pagesave më të larta nëpërmjet punëve komunitare për të përmirësuar sadopak nivelin ekonomik të këtyre familjeve.

Gjetje gjatë takimeve me komunitetin

Në lidhje me ujësjellësin kanë shprehur shqetësime të punëve pa kontroll e pa cilësi një problem që do pasojë gjatë dimrit me demtim të tubacioneve të sapovëna për shkak të ngricave. Qytetarët mendojnë se lidhjet e reja në disa pallate po bëhen kot sepse para 7 apo 8 vitesh janë të paisura të gjitha hyrjet me matësa të ujit, ndërkohë ky investim po i rivendos duke ju shkaktuar dëme të mëdha në pallate e po ashtu shpenzime shtesë në lidhjen e ujit nga korridoret e jashtme në apartament e llogaritur në masën mesatarisht 8000 lek/banësë, po ashtu konsumatorët në banesa private në zonen e periferisë janë shprehur se puseta e matësit është vendosur në një largësi shumë të madhe nga banesa duke bërë që kjo linjë të jetë shpenzim i tepërt e i panevojshëm për familjarët, pasi është detyrë e ndërmarrjes së ujësjellesit kujdesi për rrjetin deri në pikën më të afërt me banesën.

Një shqetësim tjetër i hasur tek banorët është investimi në fasada për të cilin ka banorë që shprehen se nuk janë trajtuar njësoj me banorët e tjerë të të njëjtit pallat apo hyrje, investimi kishte për detyrë të zëvendësonte dritaret apo vetratat e ballkoneve të amortizuara me të tjera të reja ndërkohë tek disa apartamente i kanë realizuar ndërsa tek të tjera jo i referohemi pallatit afër drejtorisë së policisë.

Tek pallati i ish bukës një tjetër banorë shprehet se që kur i ndërtuan çatitë e reja sa herë bie shi banesa në kat të parë në muret e brendshme të saj rrjedh ujë dhe edhe pse është ankuar disa herë askush nuk është përgjigjur për problemin e saj.

Banorët që kanë jetuar në pallatin e NSHN-së i cili po i nënshtrohet rikonstruksionit janë larguar nga aty pa një mbështetje për tu strehuar në apartamente me qera të cilën vetë nuk kanë mundësi për ta përballuar.

Tashmë është problem i relatuar edhe në institucione të ndryshme puna e fasonerive në Pukë përveç standarteve të ulëta në kushte pune e pagesa, puntorët janë hasur me abuzimin e mospagimit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëmarrësi, kështu në 14 vite punë në këputari vetëm 4 vite rezultojnë të siguruara pjesa tjetër 0 lekë të derdhura për sigurime, e njëjta situatë në punishten e prodhimit të maskave ku nga 10 vite punë rezultojnë vetëm 4 vite me siguracion.

Për çështjet e punësimit kryesisht për të rinjt dhe gratë nuk ka një plan të miratuar duke lënë si shpresë të fikur qëndrimin e të rinjëve në Pukë me sytë vetëm nga administrata publike e cila çdo ditë është duke u reduktuar për shkak të largimit të popullsisë kryesisht popullsia e re. Situata e biznesit është në nivele shumë të ulëta sa i takon mundësisë së punësimit e sidomos periudha e Covid që vazhdon të jetë prezent e ka dëmtuar rëndë edhe në atë nivel që ishte më parë. Përfaqësi nga biznesi shprehen se asnjë masë që ka ndërmarrë qeverisa nuk ndihmon daljen nga kriza e krijuar deri tani.

Në zonat rurale vazhdon të mbetet problem kanalet vaditëse, mungesa e tregut për produktet, mungesë e kapaciteteve për aplikime në skemat mbështetëse për fermerët dhe bujqësinë e blegtorinë, subvencione të papërfituara në asnjë rast, "Na ndihmoni të bëjmë jetën më të lehtë" u shpreh një nga zonjat në takimin që realizuam me banorët në Qelez, e cila kërkonte ndërtimin e kanalit të ujit që të vadiste token.

Nga takimet me qytetaret dhe intervistat e strukturuar rezultojnë:

- 70% e të intervistuarve vleresojnë punën e Bashkisë Pukë.
- 70% e personave nga zonat rurale mendojnë se investimet në zonat rurale janë minimale. Keto investime kryesisht janë në mirëmbajtjen e rrugëve, urave dhe pastrimin e disa kanaleve kulluese.
- 75% mendojnë se nuk ka programe për të rinjtë me synim punësimin apo mbështetjen me programeve të specializuara për mbështetje financiare për startup-et rinore nga Bashkia Pukë.
- 65% mendojnë se në lidhje me programet për zhvillimin e grave dhe vajzave Bashkia Pukë nuk ka zhvilluar programe për rastet e dhunës në familje dhe mungojnë programet për rritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave në mënyrë që të përgatiten për tregun e punës, kjo sidomos në zonat rurale.
- 75% e të intervistuarve kërkojnë lehtësim të taksave dhe pagesave të ujit dhe dritave sepse për shkak të pandemisë botërore të ardhurat e tyre janë zvogëluar.
- 80% nuk kanë informacion në lidhje me mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Rekomandime

- Të miratohet bonusi i qerase për të gjitha familjet e pallatit të NSHN-së deri në kthimin në banesat e tyre,
- Të kërkohet llogari nga projektuesi dhe zbatuesi i projektit të ujsjellësit të merren masa për lidhjet e ujit me banesën nga investitori e jo nga banorët dhe për rastet kur i kanë realizuar vetë banorët të ju kompensohet vlera e shpenzuar për lidhjen e ujit.
- Të parashikohet vendosja e dy vetratave te reja në pallatin afer deges së Policisë.
- Bashkia të shikojë me prioritet çdo ankesë të banorëve të saj e për pasojë të evidentohet dhe riparohet lagështira që krijohet në katin e parë të pallatit të ish-bukës
- Të merren masa deri në detyrimin e pagesës së sigurimeve shoqërore të mohuara prej vitesh për punëtorët e fasonerive në Pukë
- Të fillojë hartimi i një strategjie apo plani zhvillimi vendor për punësimin e të rinjëve dhe grave,
- Të ndërtohen grupe pune që evidentojnë problemet e zonave rurale, të ndihmojnë në përgatitjen e aplikimeve për skemat e ndryshme të mbështetjeve ndaj fermerëve
- Këshilli bashkiak të ndërtojë mekanizma të gjithpërfshirjes qytetare në vendimarrje,
- Nevojitet më tepër bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse dhe grupet e interesit për të zhvilluar nje process efektiv konsultimi.
- Këshilli Bashkiak mund të realizojë marrëveshje ose memorandume bashkpunimi me organizata dhe grupe interesi për nxitjen e pjesmarrjes së qytetarëve në vendimarrje duke bërë procese efektive dhe transparente.
- Në kushtet e Pandemisë Globale nevojitet të zhvillohen mjetet e komunikimit elektronik aplikacione mobile, rrjete sociale, komunikime online, video konferenca etj ku qytetarët kenë lehtësi pjesmarrjeje.

Anekse

Aneks 1: Prioritetet e kontratës Sociale

Prioritet 1: Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:

- Të rinjtë e sapo diplomuar.
- Gratë.
- Gratë viktimë të dhunës në familje.

Prioritet 2: Adresimi me prioritet i rregullimit të rrugëve në nivel bashkie.

Prioritet 3: Adresimi me prioritet i vendosjes së transportit publik, sidomos në ato zona i cili mungon totalisht.

Prioritet 4: Adresimi dhe listimi prioritar për ngritjen e shërbimeve për grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Prioritet 5: Ngritja e programeve dhe organizimi i fushatave ndërgjegjëse kundër dhunës me bazë gjinore.

Prioritet 6: Unifikimi i shërbimit dhe cilësisë së pastrimit për të gjitha zonat që janë pjesë e bashkisë Pukë. Shtimi i koshave në njësitë administrative dhe zonat periferike ku mungojnë dhe kontroll më i shpeshtë nga bashkia.

Prioritet 7: Adresimi dhe rregullimi i furnizimit me ujë të shkollave si dhe rregullimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kontrolli i cilësisë së tij nëpër fshatra.

Prioritet 8: Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

Prioritet 9: Ngritja e akademisë sportive (zhvillimi i shumësporteve për aktivizimin rinor)

Prioritet 10: Lobimi dhe mbështetja nga bashkia në lidhje me bursat e ekselencës



Prioritet 11: Nevoja për hapjen e kurseve profesionale me bazë zhvillimin e aftësive për turizëm si një fushë prioritare e zhvillimit të Pukës duke sjellë kështu edhe rritjen e punësimit të të rinjve dhe grave.

Prioritet 12: Zhvillimi dhe identifikimi i zonave turistike, tabelat informuese, shtigjet malore, informacion i zgjeruar për zhvillimin e zonës së Pukës.

Prioritet 13: Kërkesa për të hapur një qendër rinore.

Prioritet 14: Rishikimi i ndihmës ekonomike veçanërisht për gratë kryefamiljare, të divorcuara dhe ato të dhunuara.

